



**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

**RELACION SHPJEGUES**

**MBI**

**PROJEKTVENDIMIN PËR PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.05.2008 “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR.**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektvendimi “Për propozimin e projekt ligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazohet në nenin 100 të Kushtetutës, dhe synon parandalimin e shkeljeve që përbëjnë evazion fiskal nga subjektet e biznesit të madh, uljen e informalitetit kryesisht të këtyre shkeljeve nëpërmjet forcimit të penalteteve, të cilat pritet të ndikojnë pozitivisht në efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit tatimor.

Projektvendimi ka për qëllim që nëpërmjet masave shtrënguese të propozuara të ndikojë pozitivisht në uljen e evazionit tatimor, vendosjen e balancës ekonomike ndërmjet mbledhjes së detyrimeve nga ana e shtetit dhe pagesës së detyrimeve nga ana e tatimpaguesit. Nisma e ndërmarrë pritet të krijojë kushte të përshtatshme për konkurrencë të ndershme, duke mbështetur sjelljen e ndershme të bizneseve të rregullta, garantimin e të drejtave të qytetarëve në marrëdhëniet e punës dhe jo vetëm, si dhe të ndërgjegjësojë dhe edukojë kundravajtësit e ligjit që kryejnë evazion tatimor dhe shmangie tatimore. Propozimi vjen si nevojë e situatës reale dhe faktike të mosdeklarimit të punonjësve si dhe fshehjes së pagës reale tek biznesi i madh, pasojat e të cilit reflektohen në mosmbledhjen e të ardhurave tatimore.

## II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Qeveria Shqiptare në kundër të nismës së ndërmarrë për konsultimin e politikave në të gjithë sektorët me komunitetin ka ngritur strukturën e Këshillimit Kombëtar. Në kuadër të kësaj nisme, referuar të dhënave të marra nga kjo strukturë, është ngritur Grupi i Punës për vlerësimin e kuadrit ligjor dhe propozimeve të mundshme për hartimin e nismave ligjore që lidhen me ashpërsimin e gjobave dhe masave kundër evazionit fiskal të shoqërive të biznesit të madh dhe mbrojtjen e denoncuesve të informalitetit. Propozimi i këtij akti vjen si pasojë e vlerësimit të shmangies nga pagimi i detyrimeve tatimore të pagës dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore të përqëndruar në kategorinë e subjekteve të regjistruara me përgjegjësi tatimore të TVSH dhe tatim fitimit.

Projekti nuk është parashikuar në programin analitik të akteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2022.

## III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 119 pika 3, ka parashikuar penalitetet në rastin e mosdeklarimit të punonjësve dhe fshehjes së pagës.

Në kushtet e situatës reale dhe faktike të mosdeklarimit të punonjësve si dhe fshehjes së pagës reale tek biznesi i madh, pasojat e të cilit reflektohen në mosmbledhjen e të ardhurave tatimore, diktojnë nevojën që penalitetet administrative të parashikuara në nenin 119, pika 3, të ndryshohen në rritje për biznesin e madh.

Nga analizat e realizuara nga administrata tatimore rezultojnë se për 3 vitet e fundit (2019, 2020, 2021), për biznesin e madh janë vendosur:

- **1,025** gjoba për mosdeklarim të punonjësve dhe fshehja e pages, me një vlerë prej **142,336,266** lekë.

Edhe pse në kushtet e fatkeqësive natyrore si tërmeti dhe pandemia, administrata tatimore ka qënë më e kufizuar nga kontrollet/verifikimet fizike në terren, përsëri vihet re një numër i lartë i shkeljeve që lidhen me mosdeklarimin e punonjësve dhe fshehjen e pagës. Për pasojë, propozimi vjen si rezultat i domodoshmërisë për ashpërsimin e penalteteve për këtë kategori shkeljesh dhe tatimpaguesish. Ashpërsimi i penalteteve, synohet të ndikojë në reduktimin e këtyre shkeljeve, mbrojtjen e individëve të punësuar si dhe pasqyrimin real në skemën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

## **VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi “Për propozimin e projekt ligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” mbështetet në nenin 81 pika 1 dhe 100 të Kushtetutës dhe është në harmoni me Kushtetuten dhe legjislacionin në fuqi.

### **IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NËNLIGJORE)**

Nuk synohet përafrimi me Acquis Communautaire.

### **V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projekt akti i propozuar bën ndryshim në 3 të nenit 119 të ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës”.

Në nenin 1 të projekt aktit, propozohet ndryshim në pikën 3 të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës”. Rregullimi ligjor aktual parashikon se tatimpaguesi në rast të fshehjes apo mosdeklarimit të pagës së saktë të përfituar nga punëmarrësi si rezultat i marrëdhënies së punësimit , përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimit tatimor dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, dënohet me gjobë në masën 100 përqind të detyrimit

dhe kontributit të llogaritur. Projekti vetëm për subjektet e rregjistruara me përgjegjësi tatimore të TVSH-së dhe Tatim Fitimit për këtë shkelje parashikon një rritje të masës së gjobës nga 100 në 200 përqind të detyrimit dhe kontributit të llogaritur.

## **VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e projekt ligjit ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

## **VII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT DHE QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhër të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 128 datë 19.04.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe propozimet e mundshme për hartimin e nismave ligjore që lidhen me ashpërsimin e gjobave dhe masave kundër evazionit fiskal të shoqërive të biznesit të madh dhe mbrotjen e denoncuesve të informalitetit”. Në këtë grup janë përfshirë nëpunës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Inspektoriatit Shtetëror të Punësimit.

## **VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.**

Projekt akti i propozuar si pasojë e rritjes së penalteteve për shkeljet administrative të parashikuara në këtë akt, pritet të sjellë rritje të të ardhurave në Buxhetin e Shtetit sipas përqindjes së rritur në masat penalizuese të propozuara.

**MINISTËR**

[shqiptarja.com]